



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:150756

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05875912

P.nr.2023:150757

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen penale kundër të pandehurit S.K., me vendbanim në fshatin ..., Komuna Ferizaj, për shkak të Veprës penale Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.807/23/23 të datës 10.07.2023 në seancën publike të shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të Shtetit Besnik Nuredini, të dëmtuarit B.B. dhe të pandehurit S.K., me datën 25.06.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datën 28.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurit:

S.K., me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, , i lindur me ..., nga i ati Sh. dhe e ëma L. e gjinisë B., me qëndrim të përhershëm në shtetin Norvegjez në qytetin Tronhem, ka të kryer shkollën e mesme, me gjendje të mesme ekonomike, i martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Norvegjisë, me nr. personal:

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

SEPSE:

- Me datë 08.11.2022, në Ferizaj, i pandehuri me qëllim të pengimit të realizimit të së drejtës pronësore ka tjetërsuar veturën e markës “ Mercedes Benz ”, ngjyrë e bardhë, viti i prodhimit 2013, targa Norvegjeze, me numër të shasisë: WD....20, e cila veturë ishte marrë me kredi në shtetin Norvegjezë nga i pandehuri, në atë mënyrë që të njëjtën e kishte shitur të dëmtuarit B.B., në vlerë prej 7500€ (shtatë mijë e pesë qind euro) e njëjta veturë ishte e kërkuar

edhe nga autoritetet policore Norvegjeze - Interpol, ashtu që edhe pse kishte qenë i njoftuar që të njëjtën ta ruan dhe të mos e tjetërsoj, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm në vlerë të pa përcaktuar,-

-Me këtë ka kryer veprën penale Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 par. 1 të KPRK- së.

Gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 7, 17, 38, 39 par1 nënpar 1.1, 40 par.1. nën par 1.3, 43, 69, 70 të KPK-së dhe nenit 358, 359, 360, 361, 364, 365, 449, 462, të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), e

G J Y K O N

- Të pandehurit **S.K.**, i shqipton: dënim me gjobë në shumë prej 200 Euro (dyqind), të cilin dënim obligohet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formë e prerë.

- Nëse i pandehuri nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € (njëzet) euro llogaritet 1 (një) ditë burgim.

- I pandehuri obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, ekspertizës mjeko ligjore 20 € (njëzet) euro në emër të kompensimit të viktimave, të paguaj shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- I dëmtuari **B.B.**, me vendbanim në Ferizaj, Rruga “ ... ” nr...., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike nuk është udhëzuar në kontestin e rregullt civil pasi që në shqyrtimin fillestar ka hequr dorë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm, me datën 13.07.2023, në Gjykatën Themelore në Ferizaj ka ngritur aktakuzën me nr. PP/II.nr.807/23 të datës 10.07.2023, me të cilën ka ngarkuar të pandehurin **S.K.**, me vendbanim në fshatin, Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 të KPRK-së.

Gjykata me datën 22.12.2023 kishte caktuar shqyrtimin fillestar por nga fletë kthesa për dorëzim personal thuhet se gjendet jashtë vendit.

Gjykata Stacionit Policor në Ferizaj i ka bërë kërkesë për verifikimin e Adresës së vendbanimit për S. / Sh. / K., ku policia ka vepruar sipas kërkesës dhe Gjykata ka pranuar Memorandumin Zyrtar Nr.Ref...../24 dt.19.03.2024 ku kanë theksuar se personi S.K., gjendet jashtë shtetit të Kosovës në shtetin e Norvegjisë.

Pas pranimit të njoftimit Gjykata në kuptim të nenit 535 të KPP-së për të pandehurin S.K. me datën 03.04.2024 ka lëshuar Urdhëresë për Lëshimin e Letetrreshtimit Qendrorë.

Në bazë të Urdhëresës për Lëshimin e Letetrreshtimit Qendrorë i pandehuri S.K. është ndaluar nga policia dhe është njoftuar se Gjykata Themelore në Ferizaj për një veprë penale që ju ngarkon Juve ka lëshuar Letër rreshtim Qendror dhe për këtë ju janë konfiskuar dokumenti e udhëtimit- pasaporta dhe e kanë njoftuar që të paraqitet në Gjykatë ku me datën 25.06.2024 është paraqitur dhe shquar nga Urdhëresa ,gjyqtari i i ngarkuar me këtë lëndë Imri Sejda, gjendet në pushim vjetor kemi njoftuar zyrtaren e kryetarit të gjykatës ku me Vendim është ri caktuar tek Gjyqtari Adem Shabani, ku i ;pandehuri nuk ka vrejtje dhe për ket menjëherë kemi njoftuar prokurorin e shtetit dhe palën e dëmtuar të cilët me kohë janë paraqitur në Gjykatë për mbajtjen e seancës gjyqësore.

Konform nenit 241 paragrafi të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), të pandehurin S.K., gjyqtari i vetëm gjykues e ka udhëzuar për të drejtat e tij dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se i pandehuri, e ka kuptuar aktakuzën për veprën penale që akuzohet, dhe i ka ofruar mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohej i pafajshëm për veprën penale që i vihet në barrë sipas aktakuzës.

I pandehuri S.K., ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet, dhe në vazhdim thekson se për veprën penale që akuzohet dhe lidhur me rastin që ka ndodh unë nuk kam diçka të keqe dhe nuk kam dashur që t'a shes veturën e të i qes probleme të dëmtuarit, unë ia kam shitur Bujarit ku iu ka konfiskuar, por më vonë' Pasi që i janë paguar obligimet në shtetin e Norvegjisë vetura i është kthyer B., tani nuk kemi asgjë të keqe, unë tani e kam paguar kredinë e makinës dhe pronari legjitim është B.B., ku propozoj Gjykatës që të ketë parasysht rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjyqtari në kuptim të nenit 242 par.5 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), për vlerësimin e pranimit të fajësisë së të pandehurit, ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit Besnik Nuredini, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ky pranim është bërë vullnetarisht pa presion dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimit kjo ka mbështetje edhe në provat tjera materiale të lëndës, kërkojmë nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj konform ligjit duke pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe me sanksionin e shqiptuar të arrihet qëllimi i dënimit,

I dëmtuari B.B., lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri pajtohet por thekson se nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, nuk kërkojë kompensim dëmi, nuk kemi asgjë të keqe me të pandehurin, unë veturën e kam në posedim ligjërisht, nuk kam pas më asnjë problem.

Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim nenit 242 par.2 nën.par.2.1, 2.2,2.3, 2.4 të KPP-së (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), është e bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit: Raporti i Oficerit me numër të rastit 2023-CFI-22 i datës 08.02.2023, Deklarata e të pandehurit S.K. e dhënë në prokurori, me datë 04.07.2023, Deklarata e të dëmtuarit - dëshmitarit B.B., e dhënë në Polici, me datë 08.02.2023, Kërkesë për lirim të auto - mjetit e datës 16.06.2023, Sektori Rajonal i Hetimeve - Auto - Krime Ferizaj, Shkresë nga ILECU e datës 14.06.2023, Foto - dokumentacioni, si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Duke pas parasysh se gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 248 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 332 par. 4, të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L-032), atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 242 par. 2 të KPP-së, (Kodi i Procedurës Penale Nr.08/L- 032), ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale Veprës penale Dëmtimi i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 332 të KPRK-së, dhe e ka shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e saj penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69, 70, të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar

pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pendimin për rastin e ndodhur, me të dëmtuarin nuk kanë asgjë të keqe i dëmtuari nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale . Gjykata duke pas parasysh se ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe është penduar thellë për veprën e kryer penale, në përputhje me nenin 71 dhe 72 të KPRK-së, vendosi që ndaj të njëjtit të shqiptoj dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimit. Andaj, duke mos gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, ashtu që në të ardhmen të pandehurin do ta parandalojë nga kryerja e veprave penale dhe se ky lloj i dënimit, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i ka i akuzuari, dhe në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla të kundërligjshme.

Gjykata vendimin e ka mbështetur duke u bazuar edhe në neni 38 i KPRK-së i cili konsiston “parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcim detyrimin për respektimin e ligjit”.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPP-së.

Vendimi për kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 449 paragrafi 2 nën par 2.9 të KPP-së dhe në kuptim të nenit 36 parag.3 pika 3.1 1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, u thuhet “për veprën penale që gjykohet në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore shuma është prej njëzet (20) €uro”.

Vendimi për mos udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 460 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,

P.nr.2023:150757, me datë 28.06.2024

Numri i lëndës: 2023:150756
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05875912

Zyrtare Ligjore
Arbelinda Tahiri

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.